



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për “Shqipërinë 2030 në Bashkimin European””.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2024, ora 12:30

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE V

Drejton tryezën: Arjan Dyrmishi

Rendi i ditës:

Parandalimi i korrupsionit politik, integriteti i të zgjedhurve dhe drejtuesve të nivelit të lartë dhe parandalimi i hapësirave për korrupsionin/lobimin në legjislacion.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Etilda Gjonaj dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Enkeleda Olldashi, Erisa Proko, Ilirjan Celibashi, Vildan Plepi, Valbona Kuko, Erinda Ballanca, Besnik Dervishi, Orjada Tare, Gledis Gjipali, Arbër Basholli, Erisa Proko, Adam Norikane, Agim Muslia, Isabele Thomas Delic, Majlinda Thomaj, Adela Tagani, Andrea Gjoka, Loren Koçallari, Monika Cenco, Anxhela Bakiasi, Joda Tare, Blerina Ibso, Besjana Kuçi, Migena Kondo, Gentian Ndoi, Reald Keta, Juljan Hysomema, Aleksandar Matkoviç, Kejsi Ziu, Zoran Jachev, Romina Kruja, Donjet Gjoka, Artela, Mitrushi, Anila Shehi, Dëshira Mema, Rovenia Pregja, Adena Vangjeli, Stela Suloti, Avjerina Bazaj dhe Anairda Arizaj.

HAPET MBEDHJA

Arjan Dyrmishi – Mirë se keni ardhur në këtë tryezë të dytë për ditën e sotme, e cila do të fokusohet te parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit politik. Unë jam Arjan Dyrmishi, drejtor i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Do të jemi në këtë tryezë së bashku me kolegët, Enkeleda Olldashin dhe Erisa Prokon, për të prezantuar gjetjet e një raporti paraprak që kemi kryer në lidhje me korrupsionin politik. Do të doja të theksoja që, megjithëse korrupsioni politik përmendet dendur, ndryshe nga fusha të tjera, nuk është se ka shumë raporte vlerësimi, të cilat fokusohen te korrupsioni politik. Kështu që, shpresojmë që ky dokument të kontribuojë pak edhe për plotësimin e këtij vakumi. Do të theksoja paraprakisht se disa nga premiset, mbi të cilat jemi nisur së bashku me kolegët e tjerë të grupit të ekspertëve, si dhe ndarja e punëve dhe e fushave, siç e keni parë nga faqja e dedikuar e komisionit, është sipas disa zonave të caktuara që kanë të bëjnë me korrupsionin. Korrupsioni politik, ndryshe nga format e tjera të korrupsionit, presupozon vendimmarrësit politikë, dhe kjo duhet theksuar. Si i tillë, ky lloj korrupsioni ndodh në nivelet e larta të sistemit politik dhe presupozon faktin kur zyrtarët e lartë të shtetit, që duhet të hartojnë dhe të zbatojnë ligje në emër të shtetit dhe qytetarëve, janë vetë të korruptuar, pra kjo është premisa, dhe kur ata e përdorin vendimmarrjen e tyre politike për të mbështetur pushtetin, statusin e tyre apo qoftë edhe pasurimin. Kjo ishte për të bërë dallimin midis korrupsionit politik dhe korrupsionit administrativ apo burokratik, sepse ka disa përkufizime. Ndërsa, për sa i përket ndërlidhjes midis korrupsionit politik dhe korrupsionit burokratik, ky i fundit, shpeshherë, përveç agjendës individuale që shpesh ndodh në mënyrën e rishpërndarjes së burimeve të shtetit, shërben edhe si agjent i korrupsionit politik. Pra, është paksa i ndërlikuar raporti midis këtyre dy niveleve dhe ka të bëjë edhe me strukturimin e institucioneve, të cilin do të duhet që, për hir të së vërtetës, ta ekzaminojmë se sa i përshtatur është për ta adresuar këtë problem të korrupsionit politik, nga ana tjetër, edhe të kuadrit rregullativ dhe praktikave qoftë për parandalimin apo për luftën, dhe lufta presupozon (dhe terminologjia është pak fluide) parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit politik. Pjesa më e rëndësishme, kryesisht aktet rregullative të Republikës së Shqipërisë, e institucioneve që janë në këtë tryezë, fokusohen te parandalimi, i cili përmban edhe kuadrin ligjor, por përmban edhe një mjedis lejues më të përgjithshëm, që ne nuk është se e kemi ekzaminuar në këtë raport, që ka të bëjë me pritshmëritë e publikut dhe raportet që ka dhe shkallën e ndërgjegjësismit të publikut në lidhje me këtë çështje. Pak më herët po flisnim me deputeten, zonjën

Gjonaj, dhe më kujtohet se në vitin 2015 më ishte dhënë rasti të bëja një prezantim në lidhje me korrupsionin politik në një tryezë të ngjashme, dhe shumë nga pjesëmarrësit po më tallnin, po thoshin se çfarë është kjo, nga e ke nxjerrë këtë fjalë, por faktikisht është i rëndësishëm, sepse, nëse ne kërkojmë nga publiku që të kërkojë më shumë llogaridhënie nga institucionet, duhet t'i ketë edhe vetë të qarta këto. Ndaj thashë se raporti nuk e trajton në thellësi pjesën e ndërgjegjësimit, por është i rëndësishëm për pjesën e parandalimit. Ndërsa sa i takon pjesës së ndëshkimit, është pjesa që ka të bëjë me institucionet e hetimit dhe të gjyqimit që, pak a shumë, në sistemin tonë pas reformës në drejtësi mund të themi deri diku se është më e rregulluar dhe ka filluar të japë efektet e saj.

Kështu, për të prezantuar gjetjet e këtij raporti, fillimisht do t'ia jap fjalën koleges Olldashi dhe më pas Erisës për të komentuar.

Enkeleda Olldashi – Të falënderoj, Arjan!

Për të vijuar idenë që donte të konkludonte Arjani, më mirë do të ishte të përdornim dhe të adresonim mekanizmat e duhur për ta parandaluar korrupsionin, dhe ne jemi përpjekur që ta nisim nga organi më i rëndësishëm edhe për shkak të formës politike të pushtetit që ne kemi në Republikën e Shqipërisë, nga Parlamenti, nga ligjberja, dhe duke dashur ta nisim me komponentin e integritetit të zyrtarëve, sepse integriteti dhe parandalimi i korrupsionit ne besojmë se shkojnë bashkë. Kur themi që besojmë, kjo vjen edhe nga praktikat e vendeve të ndryshme, të cilat në mënyrë specifike kanë ligje që quhen kështu. Buk po shkoj më larg, por po përmend Slloveninë, e cila ka një ligj specifik që në vitin 2018, i rishikuar edhe në vitin 2020, i quajtur “integriteti dhe parandalimi i korrupsionit” dhe është ndërtuar një institucion në nivel kushtetues, sepse komisioneri dhe zëvendëskomisionerët e këtij institucioni janë në nivel kushtetues. Ne besojmë se integriteti dhe parandalimi i korrupsionit duhet të shkojnë bashkë, por me këto institucione që kemi dhe me këtë legjislacion që kemi, si mund ta forcojmë, nëse nuk do të na duhet të bëjmë ndryshime kushtetuese? Mund ta fillojmë nga disa mekanizma shumë të vegjël, që nga Kodi i Sjelljes së Deputetëve, një iniciativë e miratuar në vitin 2018, sigurisht e diktuar, e shumëkërkuar, e zgjatur në proces derisa u miratua, me nenet që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, me kontaktet e papërshtatshme, me lobimin, me informacionet konfidenciale, por nuk ka asnjë nen që të përcaktojë sanksionet, masat, institucionin dhe organin që kontrollon zbatueshmërinë e këtij Kodi. A mund ta kryejë këtë Byroja e Kuvendit, duke publikuar edhe udhëzime të detajuara sesi ky Kod duhet të zbatohet? A ka nevojë që të kemi një regjistër, të cilin mund ta quajmë “regjistri i

integritetit dhe i transparencës së të zgjedhurve tanë”, ku të evidentohen të gjitha rastet e konfliktit të interesit gjatë procesit të hartimit të ligjit, të diskutimeve në komisionet përkatëse, të miratimit dhe të votimit? Ne mendojmë se është i rëndësishëm. Ky regjistër i integritetit dhe i transparencës, i cili, sigurisht që duhet të jetë i hapur për publikun, për mediet dhe për shoqërinë civile, do të na ndihmonte të gjithë ne si qytetarë, sepse në këtë tryezë jemi edhe si qytetarë, përveçse si ekspertë, për të kuptuar integritetin e të zgjedhurve tanë. Në momentin që flasim, ne nuk kemi. Si do të mund të realizohet?! A ka nevojë, sepse ne themi se Parlamenti është organ mbikëqyrës, pra është ajo që quhet mbikëqyrja parlamentare, por pyetja është: cili e mbikëqyr Parlamentin? Në një sistem demokratik asnjë organ nuk duhet të jetë i pambikëqyrur. Në momentin që flasim, ne nuk kemi një organ që ta mbikëqyrë. Atëherë, ne propozojmë që të krijohet një mbikëqyrje, e cila duhet të jetë e pavarur dhe ata që do të jenë pjesë e kësaj mbikëqyrje të pavarur të Parlamentit, që mbikëqyr organet e tjera, duke përfshirë edhe qeverisjen, duhet të jenë nga shoqëria civile, akademikë, gazetarë, pra ka modele në botë që mund të realizohen dhe mund të merren si shembuj.

Integriteti i zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve në lidhje me parandalimin e korrupsionit

Në momentin që flasim, ne nuk kemi asnjë sistem që monitoron atë që quhet performanca e të zgjedhurve dhe zyrtarëve të lartë. Institucionet që janë këtu prezentë me ne le të na korrigjojnë nëse jemi duke gabuar. Nëse do të kemi një sistem që do të monitorojë performancën e zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve, duke i publikuar këto raporte periodike të veprimtarisë së deputetëve në një regjistër apo çfarëdo emri që mund të quhet, ai duhet të jetë i hapur për publikun, që zgjedhësit ta dinë veprimtarinë periodike të deputetëve për të cilën ata paguhen. Ku mund të konsistojnë këto raporte? Ne kemi dhënë disa shembuj se çfarë mund të përfshijnë këto raporte, por patjetër që mund të përfshijnë edhe më shumë elemente se kaq, ndër to mund të përmendim frekuencën e pjesëmarrjeve në mbledhjen e Parlamentit apo të institucioneve përkatëse, numrin dhe llojin e propozimeve apo amendamenteve të propozuara, sepse zgjedhësi nuk e di sa herë ka folur në Parlament dhe sa amendamente ka propozuar deputeti që ka zgjedhur. Pra, kërkohet një raport për performancën e deputetëve, sikundër u bëhet edhe zyrtarëve të lartë, pavarësisht se ata nuk kanë një kontratë pune, por nuk duhet të harrojnë se punëdhënësi i tyre është zgjedhësi dhe, pavarësisht se nuk kanë një kontratë pune diku duhet që zgjedhësi ta marrë këtë informacion. Patjetër, ky do të ishte një element që ka të bëjë me integritetin dhe rritja e integritetit çon automatikisht në një parandalim të mundshëm të një risku të korrupsionit.

Një propozim tjetër, që po e quajmë adresim, është një çështje që sot në të gjitha institucionet botërore demokratike është e rregulluar, madje, nëse do të shtronim një tryezë vetëm me ndërkombëtarë, do të habiteshin që nuk e kemi këtë mekanizëm. Në fakt, janë dy mekanizma që i ngjajnë derës flamur. Kjo do të thotë se ka të bëjë me një derë flamur, kur një funksionar publik kalon nga sektori publik në sektorin privat dhe e kundërta, kur një drejtor apo drejtues nga sektori privat kalon në sektorin publik. Kjo gjë duhet të lërë gjurmë. Pra, ne nuk kemi një kontroll të atij që quhet kontrolli i konfliktit të interesit pas përfundimit të detyrës apo kontrolli i integritetit para se një person, që vjen nga sektori privat, do të hyjë në sektorin publik. Këto duhet të rregullohen nëpërmjet mekanizmave që mund të çojnë në një minimizim të mundshëm të korrupsionit, i cili, patjetër, unë e them se janë si bakteret që na rrinë në zorrë që për disa prej tyre kemi nevojë, por jo për shumë, sepse na helmojnë organizmin, por disa nga mekanizmat mund të na ndihmojnë për ta minimizuar. Kështu, ky kontrolli që ne themi, është ajo periudha që quhet *cooling-off period*, për një drejtor apo një ministër pas përfundimit të këtij funksioni të lartë politik, publik, pra punësimi i tij, dhe punësimi nga sektori privat drejt sektorit publik.

Një tjetër aspekt që do ta adresoj me shpejtësi, ka të bëjë me bashkëpunimin e zyrtarëve të lartë me lobistët dhe palët e treta. Pra, ky ndërveprim është një ndërveprim që duhet të jetë i pasqyruar përsëri në një regjistër, që po më pëlqen të përdor togfjalëshin “regjistri i transparencës”, por ia vëmë si të doni emrin, mjafton të identifikojmë kontaktet, që nuk ka nevojë t’i paragjykojmë nëse janë të përshtatshme apo të papërshtatshme, por publiku, qytetarët kanë nevojë t’i dinë kontaktet e zyrtarëve të lartë të zgjedhur me palët e treta apo me lobistët dhe të jenë institucionet e tjera për të kontrolluar nëse kanë qenë kontakte të përshtatshme apo të papërshtatshme.

Shkojmë te një institucion si ILDKPKI-ja që, në fakt, kolegja ime Erisa do ta elaborojë pak më shumë, për të cilën ne do të hedhim një tezë dhe, nëse audienca këtu apo përtej kësaj sale e pranon, do të ishte mirë. Ky është një institucion që gjendet në të gjitha raportet që bëhen për Shqipërinë, ku në disa raste gjendet mirë dhe në disa të tjera jo mirë, por po përmendim raportin e fundit, të vitit 2024, të Komisionit European për Shqipërinë, ku theksohet rritja e funksioneve të këtij institucioni. Bëhet kjo rritje e funksioneve të këtij institucioni, që, në fakt, po ta lexosh ligjin, edhe aktualisht ka shumë funksione, sepse monitoron, kontrollon, parandalon, dhe duket se çfarë funksioni do t’i japim sërish. Në fakt, një nga funksionet që është evidentuar, dhe ndoshta nuk bëhet (kam edhe Arbërin, kolegun tim, që është pjesë e grupit të punës, të më korrigjojë nëse e kam gabim) ka të bëjë me verifikimin e pasurive, që mund të jenë të fshehura nëpërmjet subjekteve

private apo në pronësi të individëve të tjerë. Pra, kur deklarohet se A-ja i ka marrë borxh B-së, nuk shkohet më tej të kontrollohet B-ja, C-ja, pra ky zinxhir. Aktualisht, në këto raporte theksohet që ky kufizim në momentin që flasim, e pengon këtë institucion të kryejë atë që quhet auditim efektiv (dhe kolegja ime Erisa do ta elaborojë akoma më shumë, pra auditimet proaktive). Po e kaloj këtë institucion.

Ne kemi një rekomandim, por besoj se institucioni e ka mundësinë për ta aplikuar shumë thjesht dhe ka manuale që i ndihmojnë ata që merren me deklarimin e konfliktit të interesit dhe të pasurive, por konstatohet nga institucioni se bëhen gabime në deklarime. Kjo do të thotë që duhet të vijohet të nxirren udhëzime, ndoshta më të thjeshta, për të ndihmuar që gabimet, që njerëzit bëjnë në deklarim apo konflikt interesi, nuk kanë të bëjnë me fshehjen e tyre, por kanë të bëjnë me padijeninë e tyre për mënyrën sesi.

Do të kaloj në një çështje, që e them dhe do të vazhdoj ta them, se është elefanti në mes të dhomës, që ka të bëjë me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Ne kemi identifikuar disa rregulla që mund t'i adresojmë për ta forcuar qoftë Kodin Zgjedhor, kur të rishikohet, që besoj se do të rishikohet shpejt, ligji për financimin e partive politike, kemi vendosur disa, edhe pse është fjalë shumë e madhe, po të them “rekomandime”, por po e them dhe më mirëkuptoni, që të përcaktohen kufizime në lidhje me vetëfinancimin e kandidatëve apo donatorëve individualë. Duket këtu sikur themi pse duhet ta stopojmë, se kjo do ta bënte garën e pandershme dhe për të pasur një garë të ndershme, e cila do të thotë se ai që është më i pasuri jo detyrimisht duhet të jetë më i suksesshmi, kështu që duhet të ketë një kufizim në lidhje me vetëfinancimin e kandidatëve apo donatorëve individualë. Ne mendojmë se duhet të ketë një publikim për hartimin, zbatimin e rregullave për publikimin e financave të partive dhe të kandidatëve, që duhet të realizohet nëpërmjet një portali të vetëm, duke siguruar që ky informacion të jetë i disponueshëm për publikun. E di që kjo ndodh më shpesh gjatë fushatave zgjedhore, por duhet të jetë një gjë që duhet të ndodhë në mënyrë periodike, ndoshta nuk ka nevojë ta themi një herë, por aq herë sa do të ketë financime, dhe donacionet të mos presin një afat njëvjeçar për të.

E treta, nëse ka nevojë të vendosim kufizim për donacione të partive politike dhe të kandidatëve, është një gjë e diskutueshme, por, nëse do ta vendosim, kjo do të ishte që të kemi një konkurrencë sa më të ndershme.

Një çështje tjetër, e cila besoj se është edhe në vëmendjen e institucionit përkatës, ka të bëjë me monitorimin e medieve dhe të rrjeteve sociale. Nga ditë në ditë sot fushatat elektorale po

i largohen terrenit që ka avantazhet dhe disavantazhet e tij dhe po i mban qytetarët dhe zgjedhësit më shumë mbrapa një ekrani sesa në terren. Kjo është një pjesë që nuk monitorohet, pra nuk kemi një rregullim (kam përfaqësues të institucioneve që mund të më korrigjojnë sërish) të qartë për monitorimin e medieve dhe rrjeteve sociale dhe krijimin e disa rregullave specifike për financimin digjital të fushatave, sepse sot, ngaqë ky financim digjital konsiderohet si një shërbim dhe jo si një financim kesh, ndoshta ka një moskontroll. Transparencën dhe rolin e medias e themi gjithmonë. A duhet mediet për fushatat zgjedhore të ulin çmimet dhe të favorizojnë një grup apo një individ të caktuar? Besoj se duhet të ketë një rregull dhe duhet të vendoset një rregull në lidhje me këtë.

Hapja e procesit për zhvillimin e rregullave për financimin e partive politike besoj se është në vëmendjen e institucioneve përkatëse, kështu që po e kaloj me shpejtësi.

Financimi nga palët e treta

Palë të treta konsiderohen organizatat joqeveritare, individët që nuk janë kandidatë, që ndoshta janë më të “rrezikshmit”, për përfshirjen e tyre në fushata dhe që nuk i raportojnë burimet e financimit të tyre, sepse nuk kanë detyrim për t’i raportuar, por ata mbështesin dhe janë në *backstage*, ndoshta edhe shfaqjen e bëjnë po ata, por nuk po vazhdoj me aludime të tjera.

Janë dy momente që kanë të bëjnë me transparencën transnacionale. Një rekomandim ka të bëjë me krijimin e zyrës së rikuperimit të aseteve për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sikundër përshpejtimi i ratifikimit të konventës “Për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve publikë të huaj”. E di që pjesë të caktuara të kësaj konvente kanë filluar të aplikohen ose i gjejmë në disa legjislacione, por ratifikimi i konventës do ta bënte akoma më të qartë procesin.

Po kaloj në një moment, që është edhe momenti i fundit (shpresoj që të mos kem harxhuar shumë minuta), që lidhet me momentin e parë të diskutimit të nisur nga Arjani, me ligjbërjen e pavarur, që do ta quaja “ligjbërja me duar të pastra”, por po e quajmë kështu, meqenëse është ky togfjalësh që na shkon. Cilët do të jenë mekanizmat për të parandaluar kontrollin e korrupsionit në procesin legjislativ?! Pavarësisht udhëzimeve përkatëse të miratuara nga Ministria e Drejtësisë për një kontroll paraprak që u bëhet akteve para se ato të kalojnë në Kuvend, udhëzim i cili duket që ka bashkëngjitur manualin e përgatitur nga partnerët ndërkombëtarë për mënyrën sesi hartohen dhe sesi duhet të bëhet një kontroll i ligjit, në këtë udhëzim ka një nen, është neni 8, mos qofsha e gabuar, por edhe neni 5, edhe neni flasin, në fakt, dhe në mënyrë specifike titujt e tyre kanë të bëjnë me kontrollin e riskut të korrupsionit. Pra, është ajo që quhet *corruption proofing of*

legislation. Pavarësisht se bëhet ky *check*, ne mendojmë si grup që duhet të kemi një *double check*, që do të thotë se kjo ligjbërja me duar të pastra, duhet të ketë edhe procese kontrolli që duhet të bëhen nga Kuvendi. Pra, nuk duhet ta lëmë vetëm në dorë të ministrive përkatëse apo Ministrisë së Drejtësisë që duhet ta kalojë, por duhet të bërë edhe nga Kuvendi. Kjo ka të bëjë me identifikimin paraprak, kontrollin paraprak të projektakteve, me qëllim identifikimin e riskut për korrupsion. Jam e sigurt që do të më thoni se kjo do të kërkonte një administratë shumë të madhe të Kuvendit, por nuk është e thënë ta bëjmë për çdo ligj, por për ato ligje që janë të identifikuar dhe dihen, të cilat kanë një risk të lartë korrupsioni. Kështu që, ne mendojmë se kjo mund të realizohet edhe nga Kuvendi. Me këtë rast bëjmë edhe një *double check* të këtij kontrolli. Pavarësisht se pyetja është se kush do ta bëjë këtë gjë, mund ta bëjë një organ ekzistues pranë Kuvendit, ose një organ që mund të krijohet me qëllim për ta realizuar këtë lloj procesi. Nëse Kuvendi gjatë procesit të ligjbërjes përsëri do të marrë vendim të ndryshëm nga arsyetimi, që organi përkatës që ka bërë këtë kontroll të riskut të korrupsionit, ku ka identifikuar ndryshimet apo përmirësimet që duhet t'u bëhen neneve përkatëse, do të jetë përgjegjësi e ligjbërësit nëse do të vazhdojë ta mbajë atë pjesë të aktit, që është identifikuar nga një organ, që mund të jetë organ i pavarur. A do të na çonte kjo në një diskutim mbi atë që quhet auditim, që duhet t'u bëhet akteve ligjore përpara se ato të mund të kalojnë për t'u votuar? Ne mendojmë se po. Ne mendojmë se duhet të vendoset një mekanizëm i auditimit për ligjet e rëndësishme, kur themi të rëndësishme, e kemi për ligjet që identifikohen si me risk të lartë korrupsioni. Ky auditim duhet të bëhet nga një organ i pavarur, mund të bëhet nga ajo që quhet mbikëqyrja e brendshme parlamentare, nga një mbikëqyrje e jashtme parlamentare. Ky proces, nëse do të mund të realizohet, do të çonte në minimizim të korrupsionit.

Kam përshtypjen që jam në fund, ndaj do të them diçka shumë shkurt në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare, meqë e përmenda gjatë gjithë kohës.

Ne mendojmë se Parlamenti është pushteti që duhet të ndikojë në forcimin e mekanizmave të autoritetit, të institucioneve të pavarura dhe, nëse këtë nuk e bën Parlamenti, nuk mund ta bëjë asnjë organ tjetër. Parlamenti mund ta bëjë këtë gjë duke i dhënë rëndësi dhe duke kontrolluar se çfarë ndodh me rekomandimet e dhëna nga institucionet e pavarura, të cilat raportojnë në Parlament. Pra, këto rekomandime duhet t'i ndjekë, jo thjesht të thuhet dhe të mos ndiqen, duke bërë një *action plane*, cili është institucioni që i është drejtuar rekomandimi, çfarë bën ekzekutivi

për të implementuar ose jo rekomandimin. Kjo do ta forconte rolin e Parlamentit dhe do t'i bënte institucionet e sotme që vërtet të quhen institucione të pavarura.

Po ia kaloj fjalën koleges sime, Erisës.

Faleminderit!

Erisa Proko – Shumë faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Kërkoj shumë ndjesë, por gripi, në mungesë të theksuar të integritetit, i ka gjetur hapësirat e dobëta të sistemit imunitar dhe është ulur këmbëkryq dhe nuk do që të lëvizë, njësoj siç bën edhe korrupsioni në institucionet publike. Detyra ime tani është që të punoj fort me ndërtimin e një sistemi të mirë imunitar, në mënyrë që herës tjetër, kur të tentojë të trokasë, ta gjejë derën e mbyllur. Kjo është thjesht për shaka.

Gjithsesi, e falënderoj shumë ekipin e punës dhe të gjithë ekspertët që janë përfshirë në këtë lloj analize, sepse ka qenë një ushtrim i jashtëzakonshëm, që na ka vënë në punë për ta parë të njëjtën çështje në këndvështrime të ndryshme për shkak të eksperiencës qoftë në aspektin akademik, por edhe në aspektin praktik, pragmatik e të gjitha! Kështu që realisht na ka vënë në lëvizje dhe na ka futur në shumë mendime.

Zyshë Enkeleda e trajtoi pothuajse në mënyrë shteruese të gjithë analizën që ne jemi përpjekur ta realizojmë në kaq pak kohë, edhe në bashkëpunim me njeri-tjetrin, por, nga ana tjetër, ne duam që disa nga çështjet, për të cilat na duhet një lloj *feedback*-u edhe nga aktorë të tjerë, pra mënyra se si e shohin dhe nevoja për një lloj vendimmarrjeje, që shkojnë ndoshta përtej kësaj tryeze, shpërndahen edhe në tryeza të tjera për diskutimin e kapitujve të tjerë, çështje të cilat mund të mbivendosen dhe t'u gjendet një zgjidhje përfundimtare në një moment të dytë, pasi të kemi bërë një lloj *cross check*-u të të gjitha gjetjeve. Çështjet për diskutim do t'i hedhim në formë pyetjesh, në mënyrë që edhe audienca të na japë *feedback*-un e vet, duke bërë këtë lloj analize të brendshme, bazuar mbi gjetjet që sapo prezantoi zysh Enkeleda.

Unë, në fakt, tri çështjet e para, ose të paktën katër çështjet e para do të doja t'i grupoja në një. Në thelb kanë çështjen e konfliktit të interesave, por e shtrirë në aspekte të ndryshme.

Për sa i përket konfliktit të interesit në vendimmarrje dhe në nivel politik, por edhe në nivel administrativ dhe burokratik, është trajtimi i çështjes që lidhet me pjesën e *revolving doors*, por edhe me *reverse revolving doors*, domethënë hyrja dhe dalja te dera flamur, që zysha përmendi pak më parë, që lidhet me hyrjet dhe daljen në administratën publike, duke mos pasur asnjë lloj

kufizimi, ose duke pasur kufizime, por jo të qarta mjaftueshëm dhe të detajuara mjaftueshëm sa për t'i ngritur këto barriera, në mënyrë që sistemi të jetë aq i fortë, sa të mos lejojë askënd as ta mendojë për t'u futur apo për të dalë nga ky lloj sistemi. Këtë gjë e kemi mangësi.

Referuar diskutimeve në tavolinat e tjera, që ne praktikisht jemi përpjekur t'i ndjekim, ka qenë një përpjekje për t'i integruar parashikimet, të cilat lidhen me integritetin, duke evituar pjesën e dekriminalizimit, nuk po flasim për dekriminalizimin, këtu po flasim për çështje të integritetit, të etikës. Ka pasur një lloj qasjeje për t'i integruar këto lloj elementesh të ligji ekzistues për konfliktin e interesit, që patjetër është një iniciativë jashtëzakonisht shumë e mirë.

Ne e dimë se që prej vitit 2021 kemi një projektligj të ri për konfliktin e interesit, të përgatitur nga një grup ekspertësh, por ky projektligj (jam e sigurt, por mund të ma konfirmojë edhe Arbri) nuk ka të parashikuara asnjë lloj kufizimi në lidhje me problematikat që sjell pas punësimit, apo konfliktin e interesit të vazhdueshëm edhe pas punësimit, apo edhe kontrolle paraprake, të cilat duhet të ndodhin përpara hyrjes në administratën publike.

Në këtë aspekt do të duhet që të ketë një rishikim dhe një rivlerësim, një lloj analize gjithëpërfshirëse për integrimin e këtyre koncepteve në këtë ligj të ri. Çfarë do të thotë kjo? Praktikisht ne ngremë sisteme, mekanizma, rishikojmë kuadrin ligjor, por absolutisht nuk duhet të anashkalojmë sistemin apo *set up*-in institucional, sepse duhet që t'u përgjigjemi të gjitha këtyre kërkesave, duhet t'u përgjigjemi me kapacitet, me kompetenca të reja, me proaktivitet. Kjo ndodh vetëm kur rishikojmë dhe bëjmë një analizë gjithëpërfshirëse të të gjithë panoramës institucionale që ka në fokusin e vet luftën kundër korrupsionit, në mënyrë specifike në këtë rast Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave. Kjo do të thotë se, nëse të gjitha këto ndryshime ligjore do të reflektohen, patjetër që do të ketë nevojë për një rivlerësim të kompetencave të vetë institucionit.

Zysa e përmendi, janë të gjitha kriteret dhe kontrolle që duhet të ndodhin edhe te kodi i sjelljes ministror, edhe te mënyra se si ngrihet komisioni i etikës, edhe te mënyra se si funksionon ai, edhe tek adresimi i shqetësimeve të GRECO-s në lidhje me pavarësinë e komisionit të etikës, i cili bën shqyrtimet e rasteve, edhe të konfliktit të interesave, për trupën ministrore. Pyetja që mund të ngrihet nga kushdo, por edhe nga kjo audiencë, është: si do të funksionojë komisioni i etikës në qoftë se një çështje ngrihet për vetë Kryeministrin? Sa do ta ruajë ai këtë pavarësi, duke qenë se komisioni i etikës drejtohet nga ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet? Sa e pavarur duhet të jetë kjo strukturë? Si do të funksionojë efektivisht për të prodhuar rezultate konkrete?

Pjesa e deklarimit të interesave private dhe konflikteve të interesit, absolutisht, është një element shumë i rëndësishëm dhe ndërsektorial, na prek të gjithëve. Mund të jemi subjekte deklaruese, mund të jemi persona të lidhur, mund të jemi persona, të cilëve në një moment të caktuar mund të na kërkohet për të deklaruar burimet tona apo pasuritë tona, apo mund të jemi edhe persona që kemi kamufluar apo kemi kaluar aksionet apo interesat e zyrtarëve të lartë në emrin tonë. Kështu që, në këtë aspekt ne kemi diskutuar dhe kemi konkluduar në një lloj propozimi, që është me dy kahe.

Ne jemi shumë të qartë: korrupsioni dhe lufta kundër korrupsionit nuk është më siç ka qenë 10 apo 20 vjet më përpara. Korrupsioni tani është bërë shumë inteligjent, njerëzit dhe të gjithë zyrtarët, edhe për shkak të proceseve rutinë që ndodhin, këtu i referohem gjithmonë ILDKPI-së, si dhe çdo institucioni tjetër, sidomos për sa i përket pjesës së deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave, është kthyer në një proces rutinë.

Procesi i vettingut e vërtetoi se zyrtarët kanë filluar të ndërgjegjësohen, kanë një lloj rregullsie dhe u është kthyer në proces të brendshëm edhe pjesa e deklarimit të pasurive, mënyra se si duhet ta deklarojnë, kufizimet që ata mund të kenë dhe të gjitha me radhë. Duke qenë se korrupsioni është bërë shumë inteligjent, duhet që nëpërmjet rregullimeve ligjore, nëpërmjet vlerësimit dhe propozimit për të ndryshuar edhe konfigurimet e institucioneve përgjegjëse, duhet të jemi më proaktivë. Ne nuk duhet të presim që edhe besimi i publikut të rritet duke dhënë vetëm shifra, të cilat gjithmonë kanë një lloj kritike edhe nga BE-ja, apo çdo donator tjetër, që thonë pse janë kaq pak referime, apo pse ka kaq pak gjoba, ose pse ka një ulje të numrit. Pikërisht, sepse është kthyer në një proces rutinë. Tashmë të gjithë e dinë se cilat janë hapat dhe procedurat që duhet të ndiqen për të kryer një lloj procesi. Si ta bëjmë një institucion më proaktiv? Për një institucion më proaktiv ne i shkojmë shumë edhe rekomandimit të fundit që ka bërë Komisioni Europian në raportin për Shqipërinë, për 2024-en, që këto kompetenca të zgjerohen dhe të shkojnë drejt hetimeve proaktive, drejt hetimeve të pasurive, të cilat kanë një lloj kamuflazhi dhe janë të regjistruara edhe në emër të të tretëve, që janë të fshehura dhe nuk mund të identifikohen lehtësisht.

Aktualisht, ligji për deklarimin e pasurisë ka një element kontrolli, që lidhet me deklarimin me kërkesë, çka do të thotë se ti mund t'i kërkojë një personi të tretë të deklarojë burimet e ligjshme (Arbri mund të më korrigjojë për çfarëdo gabimi që unë mund të bëj), por vetëm në rastet kur vetë subjekti deklarues e ka deklaruar këtë gjë. Këtu e kemi të njohur palën e tretë, këtu duhet parë edhe efektiviteti që ka institucioni në kontrole të tilla: a ka pasur rezultate, si kanë ecur,

çfarë impakti ka pasur e të gjitha me radhë. Në këtë kontekst, duhet ta zgjerojmë edhe pak më shumë, duke shkuar edhe te persona dhe subjekte të tjera, të cilat realisht fshehin interesat pasurore të zyrtarëve të nivelit të lartë, duke qenë se ata janë më në fokus.

Duke marrë parasysh të gjitha këto analiza, pavarësisht se unë e përmblodha shumë shkurt, sepse është e pamundur dhe do të duhen shumë sesione për të folur dhe diskutuar në lidhje me këtë çështje, ne mendojmë se ka dy zgjidhje, ose një lloj zgjerimi kompetencash, riformatim apo rikonsiderim i të gjitha kompetencave të institucionit, duke i zgjeruar ato, por zgjerimi i kompetencave kanë kosto nga mbrapa, pasi duhen burime njerëzore, burime financiare, trajnime dhe ngritje kapacitetesh. Nëse ka një vullnet për ta çuar përpara këtë, patjetër, ne do të ishim pro propozimit të një riformatimi institucional, duke përfshirë të gjitha kompetencat që kanë dalë edhe nga diskutimet e tavolinave të ndryshme, që të bëhet një përmbledhje e kompetencave.

E dyta, të shkojmë në një krah komplet tjetër dhe të propozojmë, nisur edhe nga lloji dhe tipologjia e kompetencave që propozohet të marrë ky institucion, krijimin e një agjenci e pavarur për antikorrupsionin, siç ka edhe shumë modele të tjera në vendet në rajon. Te ky propozim ne kemi rezervat tona, sepse absolutisht modeli i Hong Kongut është modeli më i mirë në botë, por që shumë vende të tjera kanë dështuar në kopjimin e këtij sistemi, sepse nuk kanë bërë analizën e brendshme, qoftë edhe kulturore apo shoqërore, komponentët e kuadrit ligjor institucional, shpërndarjen e kompetencave. Pra, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në momentin që fillojmë dhe analizojmë apo propozojnë konkretisht këtë zgjidhje. Kjo ka risqet e veta dhe ne kemi një lloj rezerve.

Ajo që ne do të donim të shikonim në riformatimin e institucionit, dhe e hedhim prapë si tezë diskutimi, është edhe fakti që ky institucion, duke u shndërruar në një institucion proaktiv, ka nevojë që të mos jetë i prekshëm nga politika dhe formulat janë të ndryshme: ose e bën një institucion kolegjal dhe jo monokratik, ose e ngre në nivel kushtetues. Ka modele, pavarësisht se mund të jenë të pakta, ka modele (agjencia e Sllovenisë, për shembull, është në nivel kushtetues, prandaj më erdhi shumë natyrshëm për ta thënë) që realisht mund ta ngrenë në nivel kushtetues, por edhe kjo ka nevojë për diskutim. Patjetër, ta ngresh në nivel kushtetues siguron garancitë e veta, qoftë në qëndrueshmëri apo në kompetencë, por, gjithsesi, të gjitha këto janë teza për diskutim. Ne jemi këtu për t'i eksploruar të gjitha, ndoshta për të gjetur edhe zgjidhjen më të mirë dhe më të pranueshme për kontekstin në të cilin ndodhet Shqipëria.

Kjo ishte pak a shumë, pasi dua që t'i lë hapësirë edhe audiencës, në mënyrë që ta vijojmë edhe më tej këtë diskutim. Do të doja të kalonim te *slide*-i tjetër.

Pjesën e financave të partive politike praktikisht e kemi ezauruar. Duhet parë me shumë kujdes kontrolli i shpenzimet e partive politike, por, gjithashtu, edhe impaktin që kanë rrjetet sociale në jetën e secilit prej nesh, dhe këtu nuk bën përjashtim financimi i partive politike apo fushatave elektorale. Po ashtu duhet një lloj rikonsiderimi edhe i legjislacionit në pjesën se kush do të konsiderohet donacion, do të konsiderohet pjesa e ofrimit falas e reklamave (do t'i bie shkurt, sepse e di që do të më tërheqësh vëmendjen). Kështu që, do të duhet patjetër ta trajtojmë dhe ta diskutojmë më përfaqësuesit e institucioneve.

Për sa u përket mekanizmave të auditimit për pjesën e ligjeve të rëndësishme, do t'i referohem përsëri asaj që tha zysh Enkeleda, është shumë e rëndësishme që i gjithë procesi të jetë i unifikuar dhe të shkojë zinxhir me njëri-tjetrin. Domethënë, që nga momenti që propozohet një ligj, duhet të jenë evidentë dhe transparentë të gjithë ata që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këtë ligjbërje apo në këtë ligjpropozim; të ketë diskutime të hapura; të ketë rregullime tek të gjitha kodet, por edhe miratimi i një ligji të ri për lobimin, i cili do të duhet të bëjë transparent secilin prej lobuesve të ligjshëm dhe ata që nuk paguhen për të lobuar. Gjithashtu, duhet që ky proces të kombinohet edhe me *corruption proofing of legislation*, i cili nuk duhet të ngelet vetëm në duart e ekzekutivit apo në duart e një procesi, që shkon deri te formalizimi.

Nëse e shohim, tek të gjitha relacionet e projektligjeve nuk përmendet në mënyrë specifike që ky projektligj apo ky propozim e ka kaluar procesin e *corruption proofing of legislation* dhe cilat janë rezultatet. Ose, nëse ka ndodhur, edhe fiktivisht, cilat janë produktet, gjurmët rregullatore. Si janë mbushur dhe evituar hapësirat për korrupsion.

Ky diskutim nuk duhet të ndalojë këtu, por duhet të vazhdojë edhe në Parlament. Përtej kësaj, ka nevojë edhe për një kontroll postlegjislativ, për të cilin jemi në dijeni që ka filluar si proces, por ideja është që të mos bëhet selektiv, por të kthehet në një proces rutinë dhe të rregulluar...

Enkeleda Olldashi – Ose të jetë i njohur për publikun, sepse më e rëndësishme nuk është që ta bëjmë një gjë, por e rëndësishme është që ta bëjmë për publikun, sepse është pjesë e transparencës.

Erisa Proko – Këto janë pak a shumë.

Jemi të hapur për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve.

Arjan Dyrmishi – Faleminderit shumë për prezantimet, kolegë!

Do të bëj një përmbledhje të shkurtër të asaj që ju prezantuat:

E para ka të bëjë me një skanim të kuadrit rregullator dhe institucional që Shqipëria ka për adresimin e korrupsionit politik, kjo edhe për të nxitur diskutimet për sa i përket përshtatshmërisë së këtij kuadri. Aktualisht, Shqipëria ka Kodin e Sjelljes së Deputetëve, i cili rregullon konfliktin e interesit në vendimmarrje, legjislacionin për konfliktin e interesit dhe për deklarimin e pasurive, rregullimin e financimit të partive politike dhe, shkarazi u përmend, ligji për dekriminalizimin.

Kjo presupozon se nëse, siç e definuam, korrupsioni politik, i cili kryhet nga zyrtarë politikë dhe mund të marrë zanafillën gjatë procesit zgjedhor, do të duhet që të parandalohet atje përmes rregullimeve, të cilat mund t'i diskutojmë se sa mund të jenë të përshtatshme. Nëse të zgjedhurit dhe zyrtarët politikë përpiqen që ta kanalizojnë vendimmarrjen, atëherë do të duhet që Kodi i Sjelljes, por edhe ligji për konfliktin e interesit do të funksiononte.

Dua që ta përgatis diskutimin në lidhje me a janë të mjaftueshme si sasi dhe nëse mjaftojnë në sasi, cilësisht çfarë mund të rregullojmë brenda këtyre akteve, si dhe ligji për dekriminalizimin, që nga momenti që dikush evidentohet se ka probleme me integritetin, nxirret nga sistemi.

Ajo që kolegët evidentuan është se ky sistem do të bëhej më i përshtatshëm nëse Shqipëria do të kishte të miratuar konventën e OECD-së për sa i përket korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë, dhe kjo lidhet deri diku nga korrupsioni transnacional nga jashtë brenda, por pastaj ekzistonte korrupsioni transnacional nga brenda jashtë, në të dyja drejtimet.

Zyra e rikuperimit të aseteve, që faktikisht është një proces i tejzgjatur, ku në tri raportet e progresit të BE-së theksohet se ky legjislacion duhet të ishte miratuar, po kjo ka të bëjë jo me parandalimin, por me hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Nga kolegët u theksua, gjithashtu, se është një mekanizëm i rëndësishëm kontrolli paralegjislativ, ai që quhet *corruption proofing of legislation* dhe *post legislation corruption*. Mendoj se, bazuar mbi këto dy dimensione, sasiore dhe cilësore, mund të ishin të vlefshme diskutimet nga pjesëmarrësit, përveç kësaj, për të mos e limituar.

Vetëm thoni emrin, ju lutem, sepse nuk i njohim të gjithë pjesëmarrësit.

Dëshira Mena – Përshëndetje!

Quhem Dëshira Mena, vij nga shoqata “Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë”.

Jam shumë e lumtur që marr pjesë në këtë tryezë, e cila ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit, i cili po e gërryen çdo ditë shoqërinë tonë.

Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë, të cilin unë përfaqësoj, është i përbërë nga pjesa më e madhe e inxhinierëve në vendin tonë. Ne jemi një grup interesi që mbulojmë një aktivitet jashtëzakonisht të fuqishëm në ekonominë e vendit, që ka të bëjë pikërisht me inxhinierinë, dhe e dimë shumë mirë që ekonomia shqiptare, gati 60%-70% e saj i ka të ardhura nga inxhinieria dhe punët inxhinierike. E dimë shumë mirë që korrupsioni më i madh kryhet pikërisht në këtë sektor të ekonomisë, që është sektori më i lakmuar për të gjithë qoftë të nivelit politik, qoftë të nivelit kriminal apo të çdo aktiviteti tjetër.

Kur flasim për inxhinierinë, flasim për një sektor, i cili është jetik për ekonominë e vendit; është një sektor, i cili ka të bëjë me sigurinë e vendit dhe është një sektor, i cili duhet të menaxhohet në mënyrë shembullore, pasi do të garantonte jetën të lumtur për të gjithë qytetarët tanë. E them këtë, sepse ne kemi një shqetësim shumë të madh që ka të bëjë me korrupsionin, pikërisht me korrupsionin legjislativ. Aktualisht nuk e di nëse grupi i ekspertëve, që ka bërë një analizë për gjetjet e korrupsionit legjislativ, ka vënë re që janë dy projektligje, që po diskutohen aktualisht në komisionet parlamentare, për Urdhrin e Inxhinierit dhe për Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik, të cilat janë projektligjet më të anatemuara nga grupet e interesit, pasi përfaqësojnë në vetvete korrupsionin në nivelet më të larta. Janë dy projektligje, të cilat janë bërë nga dy deputetë të pozitës (këtu do ta lidh pak çështjen me mënyrën se si zonja tregoi për sa i përket infiltrimit të figurave ose integritetit të figurave politike, të cilat përfshihen në komisionet parlamentare). Këta janë dy deputetë aktualisht të zgjedhur nga legjislatura e mëparshme dhe kanë qenë deputetë të përfshirë në listat e mbyllura. Në këtë rast ata janë deputet, të cilët, pavarësisht nga integriteti i tyre, pavarësisht nga performanca e tyre, pavarësisht nga i gjithë *background*-i që kanë, ishin të destinuar për të qenë anëtarë të Parlamentit shqiptar. Kështu që, për ta prekur pak këtë sektor, pjesa e integritetit të figurave dhe analiza nga grupet e pavarura është jo shumë e saktë, sepse ne e dimë shumë mirë që 50% e deputetëve të zgjedhur do të jenë pjesë e listave të mbyllura, që do të thotë se askush nuk do t'ju bëjë një analizë dhe ata do të jenë deputetët që nesër pasnesër do të bëjnë në njëfarë mënyre korrupsionin e ligjësuar, siç është rasti konkret. Pjesa tjetër e deputetëve, që do të zgjidhen me fuqinë e tyre, me performancën e tyre, ndoshta nuk do të kenë peshën e duhur për të ndikuar dhe për ta përmbysur këtë sistem.

Këta dy deputetë, që kanë bërë këto dy propozime për Urdhrin e Inxhinierit dhe Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik, unë dyshoj që do t'i kemi përsëri në legjislaturën tjetër. Ndonëse janë ndeshur me një kundërshti të jashtëzakonshme nga grupet e interesit, janë evidentuar të gjitha të metat e këtyre dy projektligjeve, është thënë që këto janë dy projektligje kërkojnë të rrëmbejnë pushtet nga organet qeveritare dhe t'ia kalojnë një grupi njerëzish, të cilët do të futen në Urdhër, përsëri ato vazhdojnë të jenë duke u diskutuar dhe duke u konsideruar. Në këtë pikë, ndoshta një propozim konkret, që na vjen natyrshëm ne si grup interesi dhe që mund të jetë vlerë për procesin, do të ishte që të shikojmë një detaj që projektligjet në momentin që diskutohen, të kenë një afat kohor për t'u përmbyllur. Pra, nuk mund të bësh një projektligj, ta mbash 4 vjet në diskutim, derisa njerëzit të lodhen, grupet e interesit të lodhen dhe një ditë të bukur ai të aprovohet pa e marrë vesh askush se si ishte rezultati dhe analiza që iu bë atij projektligji.

Një projektligj ka një cikël. Pas 6 muajsh, nuk e di se si mund të jetë, ekspertët mund t'i bëjnë një analizë dhe të thuhet që, nëse ai projektligj nuk arrin të shqyrtohet, nuk nxjerr në pah, nuk analizohet, atëherë ai konsiderohet i refuzuar automatikisht. Është një zgjidhje...

Arjan Dyrmishi – Faleminderit!

Pavarësisht temës, ju e nxorët në pah problemin, që ka të bëjë pikërisht me nevojën që theksuan edhe kolegët që, nëse do të kemi një proces të standardizuar të verifikimit paraprak në procesin legjislativ, automatikisht do të niste jo vetëm në këtë fushë, por ndoshta edhe në fusha të tjera.

Dëshira Mena – Pa diskutim.

Arjan Dyrmishi – Besoj se doli e qartë dhe duhet të kemi parasysh edhe limitet kohore.

Dëshira Mena – Pa diskutim. Ideja është e gjitha në linjë, thjesht doja që ta konkretizoj, në mënyrë që gjithsecili ta kuptojë, sepse, kur flitet me fjalë të përgjithshme, duket sikur flas në *cloud*, por, në fakt, nuk po flasim në *cloud*, por po flasim me këmbë në tokë për gjërat që na prekin çdo ditë në jetën tonë.

Faleminderit shumë për mundësinë!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit për kontributin!

Është e qartë çështja që parashtruat.

Zoti Celibashi e ka kërkuar fjalën.

Ilirjan Celibashi – Faleminderit, Arjan, për ftesën!

Natyrishë që në diskutime të tilla apo në platforma të tilla ka edhe firo, duhet të jemi të sigurtë dhe ta pranojmë, por kjo nuk e zbeh aspak rëndësinë e diskutimeve të gjithsecilit prej nesh dhe përgjegjësinë në platforma të tilla.

E tha me të drejtë profesoreshë Enkeleda që elefanti në dhomë, në fakt, është financimi i partive politike dhe i kandidatëve, pasi nga mënyra se si të zgjedhurit zgjidhen apo nga mënyra si e krijojmë qeverisjen tonë, varet edhe përcaktimi i cilësive të kësaj qeverisjeje. Ndaj është me rëndësi parësore që të konsiderojmë dhe të adresojmë të gjitha problematikat që lidhen me financimet e partive politike, të kandidatëve dhe të fushatave zgjedhore në përgjegjësi.

Më vjen mirë që pashë në këto gjetjet e analizës apo të studimit tuaj të njëjtat shqetësime, të cilat ne si institucion përgjegjës për administrimin e procesit zgjedhor, i kemi evidentuar më herët, në bashkëpunim edhe me partnerët tanë të ndryshëm, të shoqërisë civile apo edhe me institucione të tjera ndërkombëtare, të cilat ia kemi prezantuar edhe Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, fatin e të cilit, në kuptim të përmbushjes së qëllimit të tij, e dimë të gjithë. Për fat të keq, këto rekomandime, që rezononin shumë mirë me ato tuajat, nuk u adresuan nga Kuvendi i Shqipërisë. Të gjitha ato çështje, që lidhen qoftë me rregullat e qarta të mekanizmit të financimit, të vlerave të financimit, të mekanizmave kontrollues, të financimit të palëve të treta, që është një çështje që do të duhet ta pranojmë që jo të gjithë e kuptojnë domethënien e këtij koncepti; rregullat për zhvillimin e fushatës zgjedhore në rrjete sociale apo në medien *online* e të tjera si këto, sikurse e thashë, nuk gjetën rrugën si amendime në Kodin Zgjedhor. Mendoj që me mekanizmin e ri dhe platformën e re të krijuar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet këtij komisioni të posaçëm parlamentar, i cili adreson në përgjithësi, me sa kam parë, çështje të mirëqeverisjes dhe, në vijim të kësaj, çështje që lidhen me sundimin e ligjit apo me antikorrupsionin, besoj që, edhe sikurse duket nga ky diskutim i sotëm, do t'i risjellim në vëmendje të të gjithëve, të palëve të interesuara po se po, por të kujtdo tjetër dhe, ndoshta, do të gjejnë rrugën e adresimit të përshtatshëm nëpërmjet ndryshimeve të Kodit Zgjedhor. Ndaj jemi këtu sot duke konfirmuar jo vetëm interesin tonë për çfarë kemi përcjellë si shqetësim lidhur me këtë çështje, njëkohësisht edhe besimin që nëpërmjet kësaj strukture dhe nëpërmjet kësaj platforme, ka mundësi që partitë politike dhe Kuvendi i Shqipërisë të risjellin në vëmendje një çështje kaq të rëndësishme, sikurse është financimi i partive politike dhe i subjekteve zgjedhore.

Për ta përfunduar, i falënderoj organizatorët e këtij takimi, por edhe anëtarët e komisionit të posaçëm parlamentar “Për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit” që po na japin

një mundësi të dytë, të paktën për rastin tonë, për të bërë prezente edhe njëherë të gjitha problematikat që lidhen me financimin e partive, të fushatave zgjedhore dhe të subjekteve.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit, zoti Celibashi!

Në fakt, edhe kolegja më herët, por edhe ju e përmendët procesin e rekrutimit të deputetëve, përveç financimit, thjesht për të mbajtur edhe ne shënime. Ju përmendët që keni propozuar disa amendamente konkrete në lidhje me procesin e rekrutimit të kandidatëve...

Ilirjan Celibashi – Këto në kuadër edhe të asaj që ne e quajmë mekanizmi që vepron bazuar në ligjin për dekriminalizimin.

Vildan Plepi – Përsëndetje!

Vildani nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).

Ndërhyrja ime është në të njëjtën linjë me këtë që sapo përmendën zoti Celibashi dhe profesoreshtë Olldashi në lidhje me financimin e partive politike, për arsye se NDI-ja ka një kohë relativisht të gjatë që ka punuar në këtë drejtim, që nga viti 2016, fillimisht me financimin e USAID-it dhe vitet e fundit me financimin e vazhdueshëm të ambasadës britanike. Më duhet të them që në krye të herës se një nga çështjet që duhet ta theksoj, është se legjislacion që rregullon financimin e partive politike, është paksa i shpërndarë. Pra, kemi një pjesë të rregullimeve në Kodin Zgjedhor që kryesisht synojnë rregullimin e financimit gjatë fushatës zgjedhore, por kemi edhe rregullime për financimin të ligji për partitë politike dhe në disa pika këto rregullime nuk rezonojnë me njëri-tjetrin.

Kemi një parashikim kushtetues, një nen, që është shumë i qartë që thotë se financimet e partisë politike duhet të bëhen publike kurdoherë. Domethënë, kemi një legjislacion që është paksa i shpërndarë. Në këtë prizëm, mendoj që vlen të rishikohet një propozim që, në fakt, është bërë edhe nga disa parti politike, që të kemi një kuadër rregullator të financimit, që është më i konsoliduar, i thënë më thjesht, të kemi një ligj të veçantë për financimin e partive politike dhe jo ta lemë të shpërndarë në legjislacione të ndryshme. Ky është shembulli që kanë ndjekur edhe shumë vende të tjera në këtë drejtim.

Për pjesën e palëve të treta, u përmend edhe më parë, prej shumë vjetësh e kemi advokuar një gjë të tillë. Në fakt, edhe ODIHR-i e ka si rekomandim nr.17, nëse nuk gabojmë, në raportin e fundit për zgjedhjet e përgjithshme, ku kërkon që të shikohet mundësia për t'i rregulluar edhe palët e treta. Ne kemi pasur raste në zgjedhjet e kaluara, për shembull unë personalisht në faqen time të

“Facebook”-ut kam parë shpeshherë faqe, të cilat bënin fushatë elektorale, por nuk dihej se cilat ishin këto grupime, kush i mbështeste këto.

Një studim që bëri BIRN-i para 2-3 vjetësh për të parë palët e treta dhe ndikimin e tyre, kryesisht nëpërmjet medieve sociale, arriti në konkluzionin që faktikisht këto grupime harxhojnë shuma të konsiderueshme parash, të cilat nuk e dimë se nga vijnë. Pra, legjislacioni ynë nuk e njeh fare termin palë e tretë, ndërkohë që shumë vende të tjera kanë ecur dhe kanë legjislacion që rregullon palët e treta. Në vetvete palët e treta nuk përbëjnë problem, apo jo?! Domethënë, përfshirja e palëve të treta në fushata mund të shikohet edhe si një shenjë e mirë e demokracisë në zgjedhje, por, nëse ato i lëmë të parregulluara, them që kemi lënë një hapësirë për manipulim. Përveç të tjerave, është një hapësirë shumë e mirë edhe për ndërhyrjen e shteteve të tjera, të shteteve të huaj, të ndikimit të huaj në Shqipëri. Duke qenë një fushë që nuk rregullohet, shumë mirë një shtet i caktuar që ka interes të caktuar, mund të financojë një grupin, një individ për të ndryshuar një fushatë, ndërkohë ne nuk e kemi fare të rregulluar.

Kjo ishte një nga pikat që u përmend. Vetëfinancimi i kandidatëve, gjithashtu, mendoj që është goxha i rëndësishëm. Nuk e di përse legjislacioni ynë ka dështuar të adresojë pjesën e vetëfinancimit të kandidatëve. Kemi rregullime për çdo donator fizik apo juridik, pra ka përcaktime të qarta se sa mund t’u dhurojnë partive politike ose fushatës, por kemi harruar vetëfinancimin e kandidatëve, nuk kemi asnjëfarëlloj... Rregullatori i KQZ-së ka bërë një parashikim të një nga aktet nënligjore, por e ka futur në një nga modelet e raportimeve që përcakton se edhe kandidati vetë është subjekt i të njëjtave rregullime, siç është çdo donator i fushatës elektorale, por ka vend aty për t’u parë kjo gjë.

Shqipëria para ca vjetësh ka kaluar një ligj për kriptomonedhat. Okej, realiteti shqiptar, ndoshta, është larg realitetit të vendeve të tjera, në kuptimin se sa përdoren këto. Unë personalisht nuk është se jam shumë i informuar mbi të, por mund të jetë me vend një sugjerim që të ndalohen donacionet ndaj fushatave zgjedhore apo partive politike nëpërmjet kriptomonedhave, sepse, siç e dimë, është shumë e vështirë që të gjesh burimin dhe identitetin e vërtetë të individëve apo të grupimit që qëndron pas një donacioni të ngjashëm.

Një pikë e fundit, që është shumë e rëndësishme, ka nevojë që të kemi një kuadër rregullator që nxit ose rregullon edhe ndërveprimin institucional të disa institucioneve, që duhet të merren me mbikëqyrjen e ndikimit të huaj në Shqipëri. Në përgjithësi institucionet në Shqipëri fokusohen te ligji organik që rregullon, si të thuash, vetë institucionin, por, kur vjen fjala te veprimi

ndërinstitucional, nëse nuk kemi një kornizë ligjore që e rregullon, që e përcakton më mirë, mendoj që e kemi një hendek që duhet adresuar, sidomos kur bëhet fjalë për ndikimin e huaj.

Këto janë disa nga pikat. Nuk dua ta zgjat. Ndoshta do të ishte mirë që dokumentin ta prezantojmë si NDI edhe pranë komisionit të nderuar.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit!

Nuk e di, nëse është e mundur, t’i dërgoni në komision këto rekomandime, për t’i integruar më pas në raport dhe ndoshta për të bërë një tryezë të mëtejshme, sepse ideja është që ka disa tema dhe mundet që kjo të sjellë në të ardhmen organizimin e tryezave më tematike, për shembull, vetëm për financimin.

Vildan Plepi – Ne kemi një studim me **SAIP** për ndikimin e huaj në Shqipëri; është një studim goxha i mirë dhe e kemi dorëzuar te komisioni që merret me ndikimin e huaj. E ka emrin pak të gjatë dhe nuk më kujtohet, por edhe atë mund ta sjell së bashku me rekomandimet.

Arjan Dyrmishi – Mund t’i dërgoni për t’i bërë më pas pjesë...

Vildan Plepi – Po, po absolutisht.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Fjala për zonjën Kuko.

Valbona Kuko – Faleminderit, Arjan!

Faleminderit edhe një herë për ftesën! Vërtet ndihemi shumë mirë që komisioni i posaçëm na ka bërë kaq aktivë dhe jemi prezentë të gjithë bashkë për të diskutuar disa gjëra që, në fakt, i kemi tashmë punë të përditshme me Kuvendin e Shqipërisë.

Do të doja të ndalesha në dy çështje të rëndësishme, që i përmendën edhe ekspertët. Ju falënderoj shumë për panoramën!

Në fakt, ishte diçka, siç e thashë, po punojmë çdo ditë dhe më vjen mirë që është theksuar edhe nga ju. Gjithashtu, e vlerësoj analizën që keni bërë për çështjet kryesore që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe për metodologjinë dhe procesin e vlerësimit parandalues të korrupsionit në procesin ligjvënës dhe rolin e rëndësishëm që duhet të ketë Kuvendi i Shqipërisë.

Së dyti, që e cekët pak, por, në fakt, është një diskutim dhe punë që po bëjmë me Parlamentin, është kontrolli poslegjislativ. Në fakt, unë nuk u prezantova, por besoj që njihem.

Unë jam Valbona Kuko, drejtoreshë e fondacionit “Westminster për Demokraci” në Shqipëri. Fondacioni tashmë prej dy vjetësh po zbaton me Kuvendin e Shqipërisë një projekt, që

mbështet Parlamentin për të forcuar rolin e tij mbikëqyrës dhe dy shtyllat kryesore, përpos gjërave të tjera, sepse kemi edhe disa çështje të rëndësishme, siç është pikërisht implementimi në Kuvendin e Shqipërisë i vlerësimit parandalues për korrupsionin.

Për të mos marrë shumë kohë, ne kemi punuar dhe tashmë kemi hartuar dhe është pilotuar metodologjia e vlerësimit parandalues për korrupsionin. Ne kemi punuar gusht me të gjitha strukturat e Kuvendit dhe mendojmë që edhe ky komision duhej të ishte në dijeni, sepse, me thënë të drejtën, është punë e Parlamentit dhe, pavarësisht se fondacioni e ka mbështetur me ekspertizën më të mirë ndërkombëtare dhe me ekspertizë lokale, i kemi bërë proceset e brendshme, me qëllim që të pronësohet nga Kuvendi dhe kapacitetet e stafëve dhe njohuritë e deputetëve të rriten. Pra, në dy vjet janë trajnuar le të themi 10 veta stafi i përhershëm i Kuvendit, 10 pjesëtarë të Shërbimit Juridik, të Shërbimit të Komisioneve dhe të Institutit Parlamentar.

Thjesht për të përmendur që stafet janë këtu dhe kapacitetet janë ngritur. Nuk mund të themi që ekzistojnë plotësisht, patjetër, sepse është një proces i gjatë, por ne do të vazhdojmë. Ajo çfarë mbetet, dhe me të drejtë ju e përmendët, është zyrtarizmi apo institucionalizimi. Metodologjia e vlerësimit parandalues të korrupsionit është pilotuar në 7 projektligje, dhe do të përmend si më të suksesshmin atë të lojërave të fatit, që është bërë prezent edhe në diskutimet, në konsultimet që Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave ka bërë për një periudhë 6-mujore. Opinioni është diskutuar në tryeza me shoqërinë civile. Po ashtu, do të përmend edhe ligjin e kaluar së fundi për Policinë e Shtetit, por edhe projektligje të tjera, që të mos zgjatëm shumë.

Tashmë është çështja e miratimit të metodologjisë, patjetër e ndryshimeve që duhen bërë në Rregulloren e Kuvendit për ta pasur detyrë funksionale. Këtu jam plotësisht dakord me ju.

Në takimin që kryetarja e Kuvendit bëri me shoqërinë civile, na erdhi mirë, sepse e përmendi, e diskutoi gjithashtu, e bëri prezente që, në vijim të miratimit të metodologjisë së kontrollit poslegjislativ, që u bë nga Konferenca e Kryetarëve në fillim të tetorit, do të vijojmë së shpejti me miratimin e metodologjisë të vlerësimit parandalues të korrupsionit.

Të dyja këto metodologji janë finalizuar dhe besoj që shumë shpejt do të miratohet edhe metodologjia e korrupsionit. Por ajo çfarë mbetet, është të kemi një strukturë të veçantë. Ju e ngritët, gjithashtu, patjetër që juristët dhe këshilltarët janë trajnuar, pra ata që kanë marrë pjesë në trajnime, dhe kanë bërë punën e tyre, por nuk mjafton, mbase duhet një strukturë e veçantë për këtë.

Faleminderit!

Nuk po merrem me kontrollin poslegjislativ, pasi kemi vijuar dhe është më në progres, i miratuar, si dhe i pilotuar.

Arjan Dyrmishi – Vetëm shkurtimisht, që të kemi mundësi që t’ua japim fjalën edhe kolegëve.

Enkeleda Olldashi – Ju falënderoj shumë!

Në fakt, ajo që ne kemi evidentuar, ishte në pjesën e fundit të asaj panorame që u bë, që ka të bëjë me miratimin e metodologjisë. Ne mendojmë që miratimi i metodologjisë mund të jetë pjesë e Rregullores së Kuvendit, pra të hyjë në atë që quhet procedurë parlamentare, sepse tani ka ardhur momenti, dhe fondacioni juaj mban emrin e një vendi të parlamentarizmit, siç është Britania e Madhe, që ne nuk kemi vetëm të drejtë parlamentare, por ka ardhur momenti të kemi procedurë parlamentare. Kështu që, miratimi i metodologjisë si pjesë e Rregullores së Kuvendit do ta detyronte këtë organizëm që, sigurisht, të krijojë dhe një organizëm për ta monitoruar, raportuar dhe bërë publik raportin dhe analizën në lidhje me...

Ju falënderoj!

Arjan Dyrmishi – Po, zonja Avokatja e Popullit.

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Jam Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Ju kërkoj shumë falje, pasi nuk arrita të isha që në fillim të diskutimit dhe të prezantimit!

Dua ta filloj me një saktësim në lidhje me çështjet kryesore që ju kishit vendosur apo çështjet për diskutim që ishin në monitor deri më tani, kjo sepse edhe e çojmë në një hulli ndoshta, ndonjëherë pak nihiliste, diskutimin.

Së pari, që grupet e interesit duhet të kenë zë në diskutimin e çështjeve, ligjeve, politikave, miratimin e ligjeve, nuk ka asgjë të keqe, por ajo që ne duhet të mënjanojmë është interesi i papërshtatshëm, interesi jo i duhur i tyre, pra përfitimi prej tyre i një interesi që nuk është në përputhje me qëllimin e mirë të zbatimit të një politike të caktuar. Pse e them këtë? Nëse do të marrim, për shembull, një ligj që kemi miratuar kohët e fundit, për të drejtën e informimit apo për çështjen e të dhënave personale, sigurisht që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të jetë në krye të adresimit, të përgatitjes së draftit, të punës që duhet të bëhet e të tjerë. Prandaj, edhe në ato çështjet që u ngritën për diskutim, duhet të evidentojmë interesa të veçantë, të papërshtatshëm, apo ndikim të papërshtatshëm nga grupet e interesit, por grupet e interesit dhe grupet e mëdha duhet të jenë pjesë e çdo lloji politike të bërë, sepse, sigurisht, edhe ato duhet të

paraqesin argumentet e tyre, se nuk ekziston asnjë vend në botë ku të mos ketë njerëz të cilët të mos punojnë për të bërë një ligj të caktuar dhe të mos jenë fare pjesë e atij grupi. Për shembull, një ligj për pakicat, për të drejtat e romëve dhe egjiptianëve, sigurisht që duhet të ketë të përfshirë romët dhe egjiptianët brenda në organizim, dhe ata kanë një interes të veçantë aty. Prandaj duhet ta saktësojmë.

Shqetësimi që unë kam sa i përket çështjes së korrupsionit, perceptimit të korrupsionit dhe asaj që, në vlerësimin tim, është një veprimtari pothuajse korruptive e një pjesë të madhe të administratës shtetërore në kohën kur përfshihet në zgjedhje, është se, edhe pse kemi bërë një numër jo të vogël ligjesh, rregulloresh, kushtesh për parandalimin e përfshirjes së administratës shtetërore në veprimtari zgjedhore, nuk ia kemi dalë që ta adresojmë këtë çështje në mënyrë thelbësore. Kemi vajtur deri aty sa kemi parë që sekretarët e përgjithshëm, që janë krerët, apo drejtorët e drejtorive, japin dorëheqjen, e pezullojnë statusin vetëm për periudhën e kohës së zgjedhjeve dhe merren me fushatë gjatë gjithë kësaj periudhe, duke pretenduar se i kanë anashkaluar detyrimet e tyre ligjore duke pezulluar statusin e tyre të nëpunësit civil, pra merren me aktivitet zgjedhor në vetë të parë. Këto krijojnë realisht një ndjesi negative për këdo, sepse humbet qëllimi për të cilin janë miratuar të gjitha ato kushte dhe rregulla, që administrata publike nuk duhet të përfshihet drejtpërsëdrejti në procesin zgjedhor, dhe në fund të ditës është edhe një veprim, në vlerësimin tim, tërësisht korruptiv, sepse korrupsioni nuk është vetëm të marrësh të holla, por edhe ta ruash vendin dhe karrigen duke bërë veprime të papërshtatshme, dhe ky është një ndër ato veprime që, në një mënyrë apo në një tjetër, nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit e shikoj si problematikë.

Një çështje tjetër që do të duhet ta trajtonim dhe ta adresonim me shumë seriozitet është *gap-i* i madh që ne kemi midis miratimit të ligjeve dhe implementimit efektiv të tyre. Ka një hendek jo të vogël midis miratimit dhe asaj që realisht ndodh në praktikë apo zbatimit efektiv të politikave të caktuara, shpeshherë edhe me qëllim, por shpeshherë edhe në pamundësi. Kuvendi, me gjithë rolin e vet shumë të rëndësishëm dhe me gjithë *leadership-in* e madh që ka pasur gjithë këto vite, e ka humbur pak atë kërkesën e llogarisë ndaj ekzekutivit, në lidhje qoftë edhe me miratimin formal të akteve nënligjore brenda afateve që parashikon ligji për vetë këtë miratim, duke kaluar vite e vite me radhë dhe ligjet bëhen inefektive, sepse nuk miratohen aktet nënligjore. Këto janë elemente shumë të vogla, që, në njëfarë mënyrë, cenojnë besimin e publikut tek administrata shtetërore, administrata publike, dhe rritin perceptimin e korrupsionit në mënyrë të papërshtatshme.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit, zonja Ballanca, për kontributin!

Në fakt, ju prekët çështjen midis ndarjes së administratës publike dhe udhëheqjes e menaxhimit politik, dhe faktikisht mendoj se këtu është thelbi. Presupozohet që vendi ka një kuadër që e rregullon këtë, dhe legjislacioni për nëpunësin civil i ka të qarta. Ndoshta kjo, ju e theksuat, ka të bëjë me zbatimin. Gjithashtu, administrata publike jo e gjitha është e rregulluar sipas ligjit për nëpunësin civil, kam përshtypjen se 10%, shumica pastaj është e rregulluar me forma të tjera. Kështu që edhe kjo mund të jetë një çështje e cila mund të meritojë më shumë vëmendje në raportin që ne po hartojmë.

Enkeleda Olldashi – Vetëm për të kthyer shkurt një përgjigje: në momentin kur aty bëhet fjalë për ndikimin e interesave të veçantë në ligjbërje, nuk bëhet fjalë për grupet e interesit që janë të regjistruara në gjykatë dhe janë të deklaruara, madje po të shohësh faqen e Kuvendit, thuhet: regjistri i organizatave, që, në fakt, po ta shtypësh, nuk ka asgjë, dhe është pjesë e Rregullores së Kuvendit, te Kodi i Sjelljes së Deputetëve, që duhet të ketë një regjistër. Ne nuk flasim për këtë, pra nuk bëhet fjalë për këtë. I gjithë qëllimi është që ne kemi pikërisht ndikimin e atyre grupeve të fshehta të interesit, dhe kam përshtypjen se edhe përfaqësuesja e këtij grupi interesi e kishte fjalën pikërisht për këto. Kështu që jemi në të njëjtën linjë.

Arjan Dyrmishi – Faleminderit!

Zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Ju falënderoj për ftesën!

Ju falënderoj për diskutimet shumë profesionale që bëhen këtu. Unë gati në të gjithë prezantimin konstatova se ndoshta një ndër fjalët më të përdorura ishte fjala “transparencë”, kuptimin e së cilës besoj se e njohim të gjithë, dhe lidhet me të gjitha aspektet që po trajtohen në këtë tryezë të nderuar, por, në fund të fundit, do të thosha se është një term që na është bërë shumë familjar, për shkak edhe të punës së përditshme. Çfarë është transparenca? Në fund të fundit, transparenca është paradhoma e luftës kundër korrupsionit, nuk ka nevojë ta shpjegoj në detaje, se, me siguri, shumica këtu e kupton më mirë se unë këtë gjë, por sa më transparentë të jemi, aq më pak mundësi korrupsioni krijojmë. Çfarë duhet të bëjmë? Natyrisht, ne duhet të investojmë në dy drejtime: e para është kultura e transparencës, për të cilën, për hir të së vërtetës, ne kemi shumë punë për të bërë; e dyta janë instrumentet që kemi në dispozicion. Ne kemi një instrument shumë të rëndësishëm, që besoj se nuk është vetëm në dorën e institucioneve pavarura, por është edhe në

dorën e shoqërisë civile apo të medias, kryesisht asaj investigative, që janë ato që quhen programe të transparencës, pra është transparenca proaktive. Ky është një instrument në të cilin ne duhet të investojmë fort, sepse nëpërmjet tyre janë vetë autoritetet publike ato që duhet të bëjnë transparent çdo hap, çdo veprimtari të tyre. Natyrisht, në këtë mund ta kompletojmë më pas edhe me një proces që ka mbetur pak mbrapa, për hir të së vërtetës, që është procesi i konsultimit publik të akteve ligjore. Një kombinim i mirë i transparencës proaktive me konsultimin publik unë mendoj se japin një ndihmë, një shtysë të madhe në këtë drejtim, si për të konsoliduar transparencën, ashtu edhe për të bërë më mirë këtë pjesën e paradhomës së luftës kundër korrupsionit.

Kaq kisha shkurtimisht.

Faleminderit!

Suksese!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit, zoti Dervishi!

E kishit fjalën për konsultimin e akteve nënligjore apo për ato ligjore?

Besnik Dervishi – Ne kemi një ligj për njoftimin dhe konsultimin publik, objekti i të cilit është i përcaktuar shumë qartë. Natyrisht, është diskutuar në shumë tryeza, ndoshta ka nevojë për përmirësime, ka nevojë për një zgjerim ndoshta të objektit të tij, ndoshta është një diskutim që nuk i përket kësaj tryeze, por që unë e konsiderova tejet të rëndësishëm për ta hedhur në këtë tryezë, sepse lidhet shumë me transparencën.

Arjan Dyrmishi – Përmendët specifikisht aktet nënligjore apo vetëm ligjet?

Besnik Dervishi – Sot është vetëm për ligjet.

Arjan Dyrmishi – Dakord.

Enkeleda Olldashi – Në fakt, ju falënderoj, sepse ligji për konsultimin publik është miratuar vonë, është e vërtetë që ligji ekziston, por nuk është një organ monitorues. Pra, ky nuk monitorohet dhe nuk bëhen publike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është në monitorim, por nuk bëhet publike gjithçka që ndodh. Kështu që është e vërtetë që duhet të rishikohet, për t'i forcuar këta mekanizma. Po, mund të jetë pjesë dhe mund ta përfshijmë edhe në analizën tonë.

Ju falënderoj!

Erisa Proko – Kam edhe një gjë të fundit. Në fakt, tek analiza që kemi bërë, ne e kemi prekur pjesën e transparencës në ligjërje për sa i përket aktivitetit parlamentar, mënyrës se si do

të duhet të ishte transparent çdo proces që nga momenti kur depozitohet projektligji në Parlament dhe jo vetëm projektligjet, por edhe të gjitha aktet e tjera normative, dhe duhet të ishin transparente dhe lehtësisht të aksesueshme nga të gjitha palët, që çdo propozim apo çdo koment, çdo proces të jetë i evidentuar në kohë reale, pra të mos pritët me muaj apo me vite dhe njerëzit të mos kenë dijeni se çfarë projektligji është depozituar në Parlament apo në çfarë faze është. Kështu që në këtë aspekt ne e kemi prekur pak procesin e transparencës, duke e ditur edhe rëndësinë, në fakt, por që edhe ligji për konsultimin publik patjetër...

Enkeleda Olldashi – Po, vlen për t’u thelluar.

Erisa Proko – Absolutisht!

Faleminderit!

Valbona Kuko – ...koha e shkurtër e programit të punës së Parlamentit dhe e konsultimit, që në shumicën e rasteve nuk lë mundësi as ta konsultosh, por edhe opinionet, për shembull, që janë hartuar për vlerësimin parandalues të korrupsionit, ato që nuk janë reflektuar në projektligje, kanë ardhur për shkak të miratimit shumë të shpejtë dhe pamundësisë për t’u konsultuar. Kështu që ky është një element që duhet parë.

Besnik Dervishi – Megjithatë, për hir të së vërtetës, duhet të themi që, të paktën në këndvështrimin e monitorimit që ushtrojmë ne, si institucion, ndaj autoriteteve publike, Kuvendi i Shqipërisë është ndër institucionet model për sa i përket publikimit të akteve. Natyrisht, është një punë pa fund, është ajo gota që mbetet gjithmonë gjysmë plot apo gjysmë bosh, sepse transparenca është një proces që nuk mbaron ndonjëherë, por unë mendoj (besoj se kjo ishte edhe fryma e asaj që thashë) që ne kemi disa elemente pozitive dhe ndoshta duhet të kapemi fort tek to dhe t’i çojmë më tej, siç është tashmë kjo transparenca që ne e kemi konsoliduar, dhe nëpërmjet instrumenteve që na jep ligji, që ndoshta nuk kanë nevojë për reforma të mëdha ligjore, mund t’i çojmë ato dhe më përpara. Pra, mbetemi fort te programet e transparencës, sepse aty bëhen të qarta, bëhen publike procedurat, por edhe çdo akt e çdo veprim i titullarëve apo i çdo funksionari të autoritetit publik.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Po, Orjada.

Orjada Tare – A lejohen dy nga një familje?

Arjan Dyrmishi – Po, po, vetëm shkurtimisht, se jemi afër fundit, megjithëse filluam pak me vonesë. Mund ta zgjasim edhe pak minuta ndoshta.

Orjada Tare – Jam Orjada nga Fondacioni *Westminster*.

Sa i përket antikorrupsionit, fjalët kyçe që u përdorën këtu ishin “integriteti politik”. Për sa u përket partive politike, u fol edhe për financimin e tyre. Sa i përket integritetit politik u fol shumë për Kodin e Etikës në Parlament, por ata që vijnë në Parlament, patjetër, janë përfaqësues të partive politike dhe mbase duhet hapur pak horizonti i punës suaj dhe mbase duhet parë ligji për partitë politike në tërësi, sepse sigurimi i integritetit të partive politike dhe kodet e etikës së partive politike duhet të jenë “A”-ja, pastaj, kur ata vijnë në Parlament, forcohen edhe më tej.

Para një viti ne kemi filluar punën me tri partitë kryesore politike për kodet e etikës; njëra nuk e dinte ku e kishte, dy të tjerat nuk e kishin. Sigurisht që për realizimin e këtyre kodeve ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe një proces vetërregullues të partive, por problemi është që ato duhet të jenë në ligj, sepse partitë vijnë e ikin, por kuadri ligjor duhet të jetë aty dhe të sigurojë pikërisht këtë gjë, integritetin në politikë, dhe kjo është shumë e rëndësishme.

Për sa i përket dekriminalizimit, gjithashtu, ne kemi bërë një studim shumë të rëndësishëm, që, me siguri, do ta ndajmë me komisionin. Sigurisht që edhe aty ka nevojë për disa ndryshime dhe kemi bërë disa rekomandime. Jemi të kënaqur që një grup deputetësh kanë marrë një nga rekomandimet tona dhe e kanë sjellë për ta diskutuar në Kuvend, është në planin aktual të punës, por shpresojmë që ai të kalojë dhe të bëhet ligj.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit, Orjada!

Po, zoti...

Gledis Gjipali – Faleminderit!

Jam Gledis Gjepali nga Lëvizja Europiane në Shqipëri, gjithashtu, ekspert i grupit të punës për rolin mbikëqyrës të Parlamentit dhe zgjedhjen e institucioneve të pavarura.

Fillimisht doja t’ju falënderoja, sepse ishte shumë i qartë prezantimi! Personalisht jam shumë dakord me zgjidhjet që propozohen, dhe nga diskutimet e parafolësve duket që ka një dakordësi për çështjet e trajtuara.

Unë thjesht doja të tërhiqja vëmendjen për një çështje që mendoj se është me rëndësi dhe në vazhdim të punës së komisionit të posaçëm dhe hapave që do të ndërmerren më tej sa i përket rrezikut të mbirregullimit, kjo për faktin se unë e shoh edhe gjatë punës, në grupin ku punoj, por edhe në prezantimet e tjera që kam ndjekur, që vazhdimisht ka sugjerime për ligje të reja, për zgjerime kompetencash të institucioneve, për krijimin e institucioneve të reja, gjë që, sigurisht, në disa raste nevojitet, por nuk është çelësi për të hapur çdo derë apo për të gjetur çdo zgjidhje. Ne e

dimë realitetin, pavarësisht vullnetit të mirë për t'i rregulluar gjërat, zbatimi i ligjeve, i rregullave, kapaciteti i institucioneve nuk është ai që shpesh duam, apo që ligjet ndërtohen duke i menduar të tilla, pra si institucione që do të funksionojnë plotësisht, apo që subjektet e tyre do të përgjigjen 100%. Ky hendek, që u përmend edhe nga Avokatja e Popullit, midis zbatimit të legjislacionit duhet të merret parasysh kur propozohen zgjidhje të reja apo rregullime, sepse mendoj se mosfunksionimi i duhur i këtyre zgjidhjeve do ta ulë dhe do ta cenojë edhe me shumë besimin tek institucionet apo te zbatimi i ligjit.

Sa i takon pjesës së integritetit mendoj se është pika kryesore dhe shumë e rëndësishme, që ndërlidhet edhe me grupet e tjera të punës, dhe aty duhet të ketë më shumë fokus sesa të shohim se si mund të kufizojmë punën e organeve vendimmarrëse nëpërmjet mbirregullimit apo vendosjeve, detajimit të kriterëve, pra të vendoset më shumë fokusi tek integriteti dhe përgjegjësia e këtyre organeve për të bërë zgjedhjet e duhura, për të mos pasur konflikt interesi dhe për të mos u influencuar nga interesa të padrejtë dhe të paarsyeshëm.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit, Gledis!

Nëse mund të marrim ndonjë koment tjetër ose...

Atëherë, unë bëra një parashtrësë në krye të herës, në lidhje me përshtatshmërinë nga pikëpamja sasiore dhe cilësore të legjislacionit. Mendoj se ndërhyrja e Gledisit bën sens për sa i përket propozimit të NDI-së nga zoti Plepi, në lidhje edhe me rregullimin në një ligj të vetëm, sepse aktualisht financimi i partive politike, siç e thatë, është i mbiburokratizuar, kështu që harmonizimi në një legjislacion do ta çlironte, si të thuash, në njëfarë mënyre, mbirregullimin. Kjo është edhe një pikë e cila, me siguri, meriton dakordësim. Njëkohësisht, edhe propozimi i Orjadës për sa i përket ligjit për partitë politike, që është relativisht i vjetër, ka shumë elemente, të cilat kanë të bëjnë me demokracinë e brendshme të partive politike, me transparencën e partive politike, ka një sërë indikatorësh ndërkombëtarë, që edhe *Westminster Foundation for Democracy* i ka adresuar edhe në nivel vendi, por edhe në nivel rajonal, që mund të duhet të reflektohen në këtë legjislacion.

I falënderoj kolegët! Po ashtu, edhe kontribuuesit në këtë diskutim!

Para se ta mbyllim, dua t'ia jap fjalën zonjës Etilda, e cila, faktikisht, si të thuash, ka rolin e përfaqësuesit, të drejtuesit, ne jemi të pavarur, por e kam fjalën në mënyrën e koordinimit nga pikëpamja e anëtarit të komisionit, të këtij komponenti që sapo prezantuar.

Etilda Gjonaj – Arjan, faleminderit shumë, në radhë të parë, për moderimin, i cili ishte vërtet shumë frytdhënës jo vetëm në metodologji, por edhe në konkluzionet që i takojnë kësaj tryeze! Ashtu siç ju thatë, unë, si drejtues i kësaj shtylle, në kuptim e anëtarit të komisionit, kam dhënë, së bashku me kolegun Braçe, mbështetjen për punën, ekspertizën tuaj, me qëllim që ajo të ketë të gjithë plotësimin e atyre që konsideroheshin si kërkesa apo çështje që do ta bënë atë një ekspertizë të pavarur, por ndërkohë edhe sa më të plotë profesionalisht.

Unë dua ta filloj me një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë tryezë, sepse, në fakt, ka qenë ndër tryezat me një kontribut shumë të vlefshëm dhe frytdhënës për sa i përket *feedback*-ut që kemi marrë nga ju, si pjesëmarrës në këtë tryezë, por, nga ana tjetër, do t'ju lutesha, duke ju nxitur, që çdo koment, raport, analizë që keni për shkak të detyrës, punës, funksionit e të tjerë, t'ia vinit në dispozicion grupit të punës, si dhe çdo sugjerim apo koment që do t'ju dalë pas këtij diskutimi, sepse jam e bindur që jo vetëm e pasqyron më shumë atë dokument pune që ekspertët kanë përgatitur, por, nga ana tjetër, përfshin elemente, për të cilat, ashtu siç tha Arjani, nëse në 2015-n kishte një ilaritet kur diskutohej për korrupsionin e madh apo për korrupsionin politik, sot jemi në këtë tryezë dhe po diskutohet për masat që do të duhen për ta parandaluar dhe luftuar korrupsionin politik në të gjitha elementet e tij.

Dua të falënderoj ekspertët, profesororeshë Olldashin, e cila e drejtoi këtë komponent, që nuk ishte aspak i lehtë, Erisa Prokon, e cila vjen nga Qendra “Instituti për Zhvillim Strategjik” dhe, patjetër, Arjanin, si pjesë edhe e grupit të ekspertëve!

Po ashtu, dua të falënderoj edhe sekretarin e përgjithshëm të ILDKPKI-së, si dhe të gjithë ekipin nga ILDKPKI-ja, edhe kryetaren, për të gjithë angazhimin aktiv që patën në këtë grup pune!

Së fundmi, më lejoni të bëj një falënderim tjetër, sepse kur tenton të japësh emra, të falënderosh edhe institucionet, harron, bën edhe gabime, dhe unë dje, në një falënderim që bëra për të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë që ishin prezentë dhe që po japin ekspertizën e tyre teknike, harrova të përshëndesja dhe të falënderoja diplomaten nga ambasada franceze, Isabelle Thomas Delic.

Faleminderit, Izabel, për të gjithë mbështetjen!

Pa dyshim, kam një falënderim për drejtoreshën Luzi, për stafin e Kuvendit, duke përfshirë Esmeraldën të parën, për të gjithë koordinimin e tryezave, Ejonën, Alketin, Aidën, Elsën dhe të gjithë grupin që është marrë me organizimin!

Një falënderim të fundit e kam edhe për përkthyesit, të cilët bënë të mundur përkthimin e diskutimeve shumë të frytshme të kësaj tryeze!

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Faleminderit për këtë fjalë të fundit!

Shihemi në takimet e ardhshme!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit